



01 Nëntor 2007

Nga: **Z. Ali Hamiti**
Kryesues i ZRrE-së

Për: **Z. Remzi Shahini**
Drejtor Menaxhues i KEK SH.A

Kopje: **Z.Et'hem Çeku**
Kryesues i Bordit të Drejtorve të KEK SH.A

Z.Paull Nelles
Antarë i Bordit

Z.Kevin McCann
Anëtar i Bordit

Z.Fatmir Rexhepi
Anëtar i Bordit

Z.Haki Shatri
Anëtar i Bordit

Z.Musa Misimi
Anëtar i Bordit

Z. Michael Farbman
USAID

Z. Fadil Ismaili
Drejtor Menaxhues i KOSTT SH.A

Z. Kevin McCann
AKM

Lënda: **Arkivimi i Tarifave të KEK-ut (përgjigje ndaj letrës së KEK-ut më 23 tetor 2007)**

I nderuar Z. Shahini,

ZRRE-ja dëshiron t'ju falënderojë për letrën tuaj të datës 23 tetor 2007, me komentet tuaja në lidhje me afatin e propozuar për shqyrtimin e dytë të tarifave të energjisë elektrike (ETR2) dhe ndryshimet e sugjeruara në të. ZRRE-ja e vlerëson mënyrën e dobishme dhe të detajuar me të cilën ju jeni përgjigjur.

Përgjigjet e vetë ZRRE-së për pikat që keni ngritur në letrën tuaj janë përcaktuar më poshtë.

1. ZRRE-ja vëren se në letrën e saj ka identifikuar një datë të synuar që është 1 janari 2008 për futjen e tarifave të reja, por ka njohur se rrethanat e jashtme mund të kërkojnë ndonjë vonesë. Në këtë rast, data e synuar e korigjuar për futjen e tarifave të reja do të ishte 1 prilli 2008.
2. ZRRE ka komentet vijuese në lidhje me detyrat e vazhdueshme që ndërmerren brenda KEK-ut:
 - a) ZRRE-ja bie dakord se do të ishte e këshillueshme të inkorporohej informacioni i përditësuar buxhetor në aplikacionin për tarifa dhe vë re se ky informacion pritet të vihet në dispozicion me 30 nëntor 2007.
 - b) Ndërsa ZRRE-ja vlerëson përpjekjet që po bën KEK-u për të rritur cilësinë e pajtueshmërinë përmes Departamentit të Çështjeve Rregullatore, nuk do të ishte e pranueshme të vonohej marrja dhe shqyrtimi i aplikimit të KEK-ut për tarifa për të qenë në pajtueshmëri me afatin e KEK-ut për rekrutim.
 - c) ZRRE-ja po ashtu bie dakord se inkorporimi i informacionit për ngarkesën e re afatgjatë të KEK-ut, dhe parashikimin e energjisë dhe burimeve në aplikacionin e tarifave, do të ishte i dëshirueshëm. Sidoqoftë, ZRRE-ja vëren se KEK-u nuk ka treguar se kur mund të vihet në dispozicion një parashikim i tillë. KEK-u gjithashtu nuk ka identifikuar se cilat janë ndryshimet kryesore në supozimet që mund shpien drejt dallimeve të mëdha prej bilancit afatgjatë të energjisë që tashmë është miratuar prej Ministrisë së Energjisë dhe Minerave.
3. Modeli i korigjuar do të ndjekë të njëjtët koncepte dhe qasje si ato që janë përdorur në shqyrtimin paraprak të tarifave. Korigjimet që janë bërë janë vetëm për qëllimet e ‘rregullimit’ të përgjithshëm të modelit dhe për ta bërë më të ‘përdorshëm’. ZRRE-ja nuk ka kundërshtime ndaj propozimit që KEK-u mund t’i bëjë supozimeve të veta për përdorimin e modelit, në rast se këto janë të justifikuara si pjesë e aplikacionit të tarifave.
4. Për sa i përket çështjeve të pajtueshmërisë me Rregullin për Vënien e Çmimeve, ZRRE-ja ka komentet vijuese:
 - a) Neni 7.5 aplikohet aty ku ZRRE-ja fillon një shqyrtim çmimesh për qëllimet e përcaktimit të një kontrolli shumëvjeçar çmimi ku do të aplikohen normat e bazuara në performancë . Aplikacioni aktual është për një shqyrtim vjetor. Në këtë rast, nenet përkatëse janë Neni 8.3, që kërkon që aplikacioni (i cili mbulon strukturën e tarifave dhe të ardhurat vjetore të lejuara) të dorëzohet të paktën 60 ditë para datës së hyrjes në fuqi, dhe Neni 27.4(b), i cili kërkon që ZRRE-ja të japë vendimin e vet jo më vonë se 45 ditë pas datës së dorëzimit. Që të arrihet pajtueshmëri me këto nene, duhet që aplikacioni fillestar të paraqitet më 2 nëntor 2007 dhe që vendimi i Bordit të ZRRE-së për tarifën të nxirret në datën 17 dhjetor 2007, për të hyrë në fuqi më 1 janar 2008.

- b) ZRRE-ja bie dakord që Neni 8.4 thotë se tarifat e miratuara më herët duhet të kenë qenë efektive për të paktën 12 muaj. Sidoqoftë, ZRRE-ja vë re se vendimi i Bordit të ZRRE-së ku aprovohen tarifat me pakicë të KEK-ut (D_39_2007) thotë se tarifat e reja do të aplikohen deri më 31 dhjetor 2007 dhe se do të aplikohet një derogim për Rregullin për Vënien e Çmimeve, në mënyrë që tarifat e reja të mund të hyjnë në fuqi prej 1 janarit 2008. Vendimi i Bordit të ZRRE-së që shqyrton tarifat me pakicë të KEK-ut të cilat janë miratuar pas rishqyrtimit (D_50_2007), nuk e ka ndryshuar këtë dispozitë. Meqenëse Rregulli për Vënien e Çmimeve është nxjerrë gjithashtu nga një vendim i ZRRE-së, një vendim vijues është në gjendje të miratojë një derogim në këtë mënyrë.
5. Pikëpamjet e ZRRE-së mbi afatin e ndryshuar për shqyrtimin e tarifave janë si vijon:
- a) ZRRE-ja pranon se do të ishte e dëshirueshme që të pritët deri sa të dhënat prej procesin buxhetor të KEK-ut të jetë i gatshëm për përfshirje në aplikacionin për tarifa, dhe në rast se kjo rezulton se nuk është e mundshme për të zbatuar tarifat e reja më 1 janar 2008, data tjetër e përshtatshme do të ishte 1 prilli 2008.
- b) Sipas Rregullit për Vënien e Çmimeve, siç përshkruhet në (4) sipër, për tarifat që hyjnë në fuqi më 1 prill 2008, data më e fundit për dorëzimin e aplikacionit të tarifave është 1 shkurti 2008, përmes një Vendimi të ZRRE-së më 17 mars 2008. Sidoqoftë, lejohen edhe dorëzimet më të hershme.
- c) ZRRE beson se përvoja në shqyrtimin e parë të çmimeve tregon se një periudhë më e gjatë për komunikim me palët e interesuara për të zhvilluar kuptim për tarifat e reja, është e dëshirueshme nëse propozohen ndryshime të mëdha në nivelin ose strukturën e tarifave. ZRRE-ja mendon se përdorimi i një aplikacioni tregues do të siguronte një periudhë për konsultim dhe komunikim.
- d) ZRRE po ashtu mendon se duhet dhënë kohë shtesë për komunikimin e tarifave të reja tek palët e interesuara për të rritur pranueshmërinë e tyre.
- e) Për këtë arsye, ZRRE-ja e konsideron afatin vijues të korrigjuar si më të përshtatshëm:
- (i) 30 nëntor 2007 – dorëzimi nga ana e KEK-ut e treguesve të të ardhurave vjetore të lejuara që janë kërkuar, dhe ndryshimet në në strukturat e tarifave për vitin 2008.
- (ii) 30 nëntor 2007 deri më 20 dhjetor 2007 – shqyrtimi i aplikacionit tregues nga ana e ZRRE-së, përfshirë konsultim joformal me palët e interesuara.
- (iii) 21 dhjetor 2007 – dorëzimi nga ana e KEK-ut e aplikacionit të tarifave (ZRRE mund të pranojë dorëzim më të vonshëm të bashkërendimit përfundimtar të të ardhurave vjetore të lejuara me kostot aktuale për 2007).

- (iv) 21 dhjetor 2007 deri më 1 shkurt 2008 – shqyrtimi nga ZRRE-ja dhe konsultim me palët e interesuara për aplikacionin e tarifave.
 - (v) 8 shkurt 2008 – Vendimi i Bordit të ZRRE-së për aplikacionin.
 - (vi) 1 prill 2008 – data për hyrjen në fuqi të tarifave të reja.
6. ZRRE-ja ka komentet vijuese në lidhje me pikëpamjet e KEK-ut për aplikacionin e tarifave:
- a) Nuk ka komente.
 - b) ZRRE vlerëson kufizimet në përlogaritjen e tarifave që pasqyrojnë kostot bazuar në Kostot Margjinale Afatgjata ose në studimin për kostot e shërbimit. ZRRE-ja do të shqyrtojë propozimet e KEK-ut për faktorët e shpërndarjes që do të aplikohen menjëherë sapo këto të merren, dhe vlerëson se si ato krahasohen me ato që janë zhvilluar nga konsulentët e ZRRE-së dhe që janë pranuar nga KEK-u në shqyrtimin paraprak të çmimeve.
 - c) ZRRE është e gatshme të shqyrtojë ndryshimet e propozuara në strukturat e tarifave nëse këto justifikohen në aplikacionin e tarifave. Sidoqoftë, ZRRE-ja ripërsërit pikëpamjet e veta që ndryshime thelbësore në strukturën e tarifave do të krijojnë pasiguri të mëtejshme tek konsumatorët për sa i përket tarifave të ardhshme, dhe mund të provokojnë kundërshti të mëdha nga palët e interesuara. Në veçanti ZRRE-ja është e interesuar për implikimet e ndryshimeve të sugjeruara për përballueshmërinë e energjisë elektrike për konsumatorët që kanë të ardhura të pakta.
 - (i) ZRRE-ja kupton se shumë konsumatorë që kanë të ardhura të pakta përfitojnë nga potenciali për të pakësuar kostot e tyre të energjisë elektrike duke zhvendosur konsumin në orët jashtë pikut sipas tarifave për kohën e shfrytëzimit. Eliminimi i këtij elementi do të rrisë kostot për këta konsumatorë dhe do të heqë sinjalet që konsumatorët të zhvendosin konsumin e tyre përtej periudhave të pikut. ZRRE-ja duhet të bindet se problemet e identifikuar me njehsorët ekzistues, nuk mund të zgjidhen përmes masave më pak drastike.
 - (ii) Struktura me tre blloqe është miratuar për të ofruar një tarifë jetësore për konsumin shtëpiak në blloqet më të ulëta (që zakonisht janë ata me të ardhurat më të pakta), të financuara nga ndër-subvencionet prej shtëpiakëve më të pasur (që konsumojnë në bllokun më të lartë). Kalimi në një strukturë një-blokeshe do të eliminonte këtë mbrojtje.
 - d) ZRRE thekson se sipas Nen 22.2 të Ligjit për Energjinë Elektrike, është përgjegjësi e Ministrit të Energjisë dhe Minierave që të përshkruajë kushtet sipas të cilave konsumatorët mund të bëhen të privilegjuar. Pikëpamjet e KEK-ut në lidhje me përshtatshmërinë e pakësimit të pragut të privilegjueshmërisë për të përfshirë konsumatorë të kyçur në shpërndarje,

duhet t'i ofrohen Ministrit. ZRRE-ja kupton se një pakësim i tillë po konsiderohet për vitin 2008¹ dhe se për këtë arsye do të jetë e nevojshme të vendosen tarifat për Shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes. ZRRE-ja nuk mendon se puna shtesë për të vendosur këtë tarifa kërkon ndonjë vonesë të mëtejshme në dorëzimin e aplikacionit.

7. ZRRE-ja vë re se Neni 9.3 e Rregullit për Vënien e Çmimeve aplikohet vetëm për kontrolle shumëvjeçare të çmimeve të cilat janë vendosur sipas metodologjisë të normave të bazuara në performancë. Megjithatë ZRRE-ja pranon se është e dëshirueshme që aplikacioni i tarifave të përfshijë informim më të mirë nëse kjo mund të pritët që të bëhet e disponueshme brenda një periudhe të arsyeshme kohore.
8. ZRRE-ja bie dakord se është e padëshirueshme që informimi me cilësi të dobët të përdoret në aplikacionin fillestar dhe më pas kjo të shqyrtohet më vonë.
9. ZRRE-ja i vlerëson shqetësimet e ngritura nga KEK. Në letrën e vet të 10 tetorit 2007, ZRRE-ja tërheq vëmendje tek rreziqet që paraqesin rrethanat e jashtme në afatin kohor të shqyrtimit të tarifave. ZRRE-ja do të vlerësonte nëse KEK-u do të ofronte më shumë informacion në lidhje me ndonjë kufizim në aftësinë e vet për të zbatuar tarifat e reja (siç identifikohet në (g)).

ZRRE është shumë e gatshme të takohet me KEK-un dhe të diskutojnë përmbajtjen e kësaj letre.

Në përputhje me parimet e ZRRE-së për të maksimalizuar transparencën në punën e saj, kjo letër dhe çdo përgjigje do të publikohet në faqen elektronike të ZRRE-së.

Pres përgjigjen tuaj.

I juaji,

Dr Ali Hamiti
Kryesues i Bordit të ZRRE-së

¹ Shtojca 1 e Traktatit të Komunitetit të Energjisë kërkon që të gjithë konsumatorët jo-shtëpiakë të bëhen të privilegjuar që prej 1 janarit 2008.